



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
VLORË**

Nr. 122 prot

Datë 19.11.2021

KËSHILLI I GJYKATËS

VENDIM

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIM E GJYKATËS SË APELIT VLORË”.

Në mbështetje të neneve 38 të ligjit Nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Gjykatës së Apelit Vlorë, i mbledhur në datë 19.11.2021 i përberë nga Kryetare e Këshillit të Gjykatës Iliba Bezati, me anëtarë Sokol Ngresi dhe Frida Gani, në mënyrë unanime,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionim e Gjykatës së Apelit Vlorë”.
- 2- Shtesat dhe ndryshime janë si më poshtë vijon:

Neni 3 “Struktura” shtohet paragrafi si më poshtë:

- *Njësia ndihmëse e gjyqtarëve.*

Pas nenit 13 shtohen nenet si më poshtë:

Neni 13/1

Njësia ndihmëse e gjyqtarëve.

Njësia ndihmëse e gjyqtarëve përbëhet nga sekretaret gjyqësore .

Përzgjedhja e sekretarëve të seancës që do bëhen pjesë e njësisë bëhet me urdhër të Kryetarit të Gjykatës. Kryetari konsultohet me gjyqtarët për përzgjedhjen e sekretarëve të seancës që do bëhen pjesë e njësisë.

Neni 13/2

Detyrat e sekretarit të seancës që bën pjesë në njësinë ndihmëse të gjyqtarëve.

Sekretari i seancës që bën pjesë në njësinë ndihmëse të gjyqtarëve, me urdhër verbal apo me shkrim kryen këto detyra:

- a) *Ndihmon gjyqtarin gjatë veprimeve paraprake apo përgatitore sipas përcaktimeve të neneve 158, 158/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile duke përgatitur projekt urdhëra apo projekt vendime.*

- b) Ndhmon gjyqtarin duke përgatitur projekt urdhëra apo projekt vendime për vendimet që merren në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve. (sigurim padie, lëshim urdhri ekzekutimi, përjashtim nga tarifat gjyqësore etj.).
- c) Ndhmon gjyqtarin duke përgatitur projekt urdher apo projekt vendime për vendimet e themelit.(Penale apo Civile).
- d) Me urdhër verbal apo me shkrim kryen edhe detyra të tjera me karakter administrativ të parashikuara në këtë rregullore që i ngarkohen nga gjyqtari.
- e) Përpunon çështjen dhe përgatit projekt vendime (civile ose penale) të thjeshta standarde me shkallë kompleksiteti të ulët për marrjen e vendimit nga gjyqtari.

Neni 13/3

Mënyra e kalimit të dosjeve nga sekretari i seances te sekretari i seancës që bën pjesë në njësinë ndihmëse të gjyqtarëve rregullohet me urdhër të Kryetarit.

Dispozita te fundit

Keto ndryshime hyjnë në fuqi menjëherë dhe të publikohen ne faqen zyrtare të internetit dhe në ambjentet e gjykatës.”

**KRYETARE
ILIBA BEZATI**

**ANËTAR
SOKOL NGRESI**

**ANËTARE
FRIDA GANI**